

**VENDIM**  
**Nr.4, datë 27.2.1997**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

|                   |                                |
|-------------------|--------------------------------|
| Rustem Gjata,     | Kryetar i Gjykatës Kushtetuese |
| Hilmi Dakli,      | Anëtar i ““                    |
| Manol Konomi,     | Anëtar i ““                    |
| Zija Vuci,        | Anëtar i ““                    |
| Alfred Kararmuço, | Anëtar i ““                    |
| Veli Budo,        | Anëtar i ““                    |
| Franc Jakova,     | Anëtar i ““                    |

me sekretare Arbenka Lalica, më datë 18.12.1996 dhe 24.12.1996 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.53/5 Akti që u përket :

K Ë R K U E S E: SHOQATA KOMBËTARE PËR MBROJTJEN SOCIALE TË TË DËNUARVE, e përfaqësuar nga kryetari Z.Pëllumb Kaso;

SUBJEKT I INTERESUAR :INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE TIRANË, i përfaqësuar nga z.Eqerem Vakjari.

**O B J E K T I**

1. Shfuqizimi i udhëzimit nr.690, datë 19.8.1996 të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, sepse vjen në kundërshtim me ligjin nr.7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit" ;

2. Shfuqizimi si antikushtetues i pikës 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.149, datë 7.5.1985 "Për edukimin dhe shpërblimin e punës së të dënuarve me heqje të lirisë".

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi degjoi përfaqësuesit e shoqatës kërkuese dhe subjektit të interesuar dhe pasi bisedoi çështjen,

**VËREN:**

Në nenin 7.1 të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit", parashikohet se invalidëve që kanë qenë të punësuar në ndërmarrjet ose në institucionet shtetërore dhe ish-kooperativat bujqësore e që janë me sëmundje profesionale ose të aksidentuar në punë u jepet nga buxheti i shtetit një shtesë mujore mbi pensionin e invaliditetit si përfitim paaftësie. Për përcaktimin e sasisë së kësaj shtesë ligji ka ngarkuar Këshillin e Ministrave, i cili me vendimin nr.381, datë 20.5.1996, e ka realizuar këtë detyrë.

Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.381, datë 20.5.1996, Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka nxjerrë udhëzimin nr.690, datë 19.8.1996 në pikën 5 të të cilit thuhet se : "personat që janë dëmtuar gjatë vuajtjes së dënimit me burg për krime ordinere dhe kanë përfituar pension invaliditeti nga sigurimet shoqërore në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.149, datë 7.5.1985 " Për edukimin dhe shpërblimin e punës së të dënuarve me heqje të lirisë", nuk përfitojnë shtesë mbi pension që parashikon vendimi i Këshillit të Ministrave nr.381 , datë 20.5.1996.

Nga sa u parashtrua më sipër, rezulton se, ndryshe nga sa pretendon pa1a kërkuese, pika 5 e udhëzimit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore nr.690, datë 19.8.1996 nuk vjen në kundërshtim me ligjin nr.7889, datë 14.12.1994. Ligjvënësi dhënie e shtesës mbi pensionin e invaliditetit e ka kufizuar vetëm tek personat që kanë qenë të punësuar në ndërmarrjet ose institucionet shtetërore dhe ish-kooperativat bujqësore dhe jo tek të gjithë subjektet që kanë përfituar pension indaliditeti sipas nenit 21 të ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 " Për sigurimet shoqërore shtetërore ".

Gjithashtu, nuk ka vend edhe për shfuqizimin e pikës 8 të VKM, nr.149, datë 7.5.1985 "për edukimin dhe shpërblimin e punës së të dënuarve me heqje të lirisë", në të cilin përcaktohen kushtet për dhënie e pensionit të invaliditetit të grupit të parë ose të dytë në masa fikse sipas nenit 25 të ligjit nr.4171, datë 13.9 .1966 të dënuarve me heqje të lirisë të aksidentuar në punë të detyruar ose që kanë

marrë sëmundje profesionale që rrjedh nga puna e detyruar gjatë vuajtjes së dënimit. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" janë shfuqizuar të gjitha ligjet, dekretet, vendimet dhe udhëzimet e mëparshme që rregullonin deri atëhere marrëdhëniet në fushën e sigurimeve shoqërore.

Megjithatë, Gjykata çmon se ish-të dënuarit që kanë përfituar pension invaliditeti për shkak të aksidentit në punë të detyruar gjatë vuajtjes së dënimit ose për shkak të sëmundjes profesionale që rrjedh nga puna e detyruar dhe invalidët e aksidentuar në punë ose kanë marrë sëmundje profesionale që kanë qenë të punësuar në ndërmarrjet ose institucionet shtetërore dhe ish-kooperativat bujqësore janë në kushte krejtësisht të barabarta si përsa i përket shkakut që ka sjellë aksidentimin ose marrjen e sëmundjes profesionale prej tyre, ashtu edhe gjendjes së tyre fizike e shëndetësore. Prandaj, duhet të sanksionohet me ligj që edhe invalidët që janë aksidentuar në punë gjatë vuajtjes së dënimit me heqje të lirisë ose kanë marrë sëmundjes profesionale gjatë punës së detyruar, të përfitojnë nga buxheti i shtetit një shtesë mujore mbi pensionin e invaliditetit si përfitim paaftësie.

Gjithashtu, duke konstatuar boshllëk legjislativ në fushën e trajtimit të të dënuarve me heqje të lirisë me shpërblime në raste aksidentesh në punë, sëmundjesh etj., si dhe në përgjithësi të trajtimit të tyre përsa i përket kushteve të jetesës, të punës, të drejtave për edukim profesionale e arsimor etj., Gjykata Kushtetuese rekomandon miratimin e një ligji tërësor për të drejtat dhe detyrat e të dënuarve me heqje të lirisë, të bazuar në dispozitat kushtetuese të vendit tonë dhe rregullat e trajtimit të të burgosurve të miratuara nga Këshilli Ekonomik e Shoqëror i Kombeve të Bashkuara me rezolutat 663 C, datë 31 korrik 1957 dhe 2076, datë 13 maj 1977.

#### PËR KËTO ARSYE ,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 26 dhe vijuesa të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me shumicë votash,

#### VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.
2. Të miratohet ligji për të drejtën e invalidëve që janë aksidentuar në punë gjatë vuajtjes së dënimit me heqje të lirisë ose kanë marrë sëmundje profesionale gjatë punës së detyruar të përfitojnë nga buxheti i shtetit shtesë mujore mbi pensionin e invaliditetit si përfitim paaftësie.

Ky vendim është përfundimtar dhe i formës së prerë.

Tiranë, më datë 27.2.1997